



REPUBLIKA E KOSOVËS
REPUBLIKA KOSOVA
REPUBLIC OF KOSOVO



KOMUNA E LIPJANIT
OPŠTINA LIPLJAN
MUNICIPALITY OF LIPJAN

E K S T R A K T

Nga procesverbali i mbledhjes së 1-rë inauguruese të Kuvendit të Komunës së Lipjanit mbajtur më 12. 12. 2017 në sallën e Kuvendit me fillim në ora 10⁰⁰

Në mbledhje prezentuan:

1. Diamant Bytyqi, anëtar
2. Rasim Hasani, anëtar
3. Arton Retkoceri, anëtar
4. Avni Olluri, anëtar
5. Daut Azemi, anëtar
6. Mehmetali Krasniqi, anëtar
7. Nehat Tërpeza, anëtar
8. Fadil Sopa, anëtar
9. Vlora Limani-Hajnuni, anëtar
10. Hyra Bytyqi, anëtar
11. Linda Shahini, anëtar
12. Anila Reçica, anëtar
13. Lulzim Rrustemi, anëtar
14. Ramiz Qeriqi, anëtar
15. Argjent Tasholli, anëtar
16. Nazmi Krasniqi, anëtar
17. Lumturije Bytyqi-Hasani, anëtar
18. Egzona Bytyqi, anëtar
19. Selatin Retkoceri, anëtar
20. Shkelzen Bislimi, anëtar
21. Albulena Kelmendi, anëtar
22. Afrim Miftari, anëtar
23. Hajdin Bytyqi, anëtar
24. Safete Amerllahu, anëtar
25. Fitim Selimi, anëtar
26. Ukë Kryeziu, anëtar
27. Ganimete Qeriqi, anëtar
28. Manush Shamolli, anëtar
29. Egzona Fazliu, anëtar
30. Arben Fazliu, anëtar
31. Lulzim Qerimi, anëtar

Të tjerë prezent:

1. Imri Ahmeti, Kryetar i Komunës
2. Sefer Tasholli, Nënkyetar i Komunës në detyrë
3. Fauz Xhemajli, Drejtor i Administratës në detyrë
4. Latif Ramadani, Drejtor i DEZH, në detyrë
5. Adem Duriqi, Drejtor i DP, në detyrë
6. Avdullah Fazliu, Drejtor i DSHMC, në detyrë
7. Ilir Tasholli, Drejtor i DPU, në detyrë
8. Nazim Gashi, Drejtor i DMSH, në detyrë
9. Imer Rrustemi, Drejtor i DI, në detyrë
10. Shkelzen Hajdini, Drejtor i DBF-së në detyrë
11. Basri Hashani, Drejtor i DRSK, në detyrë
12. Heset Sahiti, Drejtor i DSHP, në detyrë
13. Kimete Jashanica, përfaqësuese e OSBE-së
14. Përfaqësuesit e KFOR-it
15. Bekim Krasniqi, OJQ "YAHK"
16. Ylber Reçica, OJQ "Polis"
17. Fitim Sadiku, përfaqësues i OJQ-së, mediat lokale, komuniteti i biznesit etj.
18. Agim Gashi, zëvendëskomandant i Stacionit të Policisë në Lipjan
19. Hetem Arifi, Deputet i Kuvendit të Kosovës
20. Përfaqësues të mediave dhe
21. Numër i konsideruar i qytetarëve

Procesverbalin nga kjo mbledhje e mbajti **Sami Murati**.

Mbledhjen e kryesoi anëtari më i vjetër i Kuvendit Nazmi Krasniqi i cili fillimisht përshëndeti të pranishmit dhe në vazhdim kërkoi nga procesmbajtësi që të thirr me emër anëtarët e Kuvendit dhe pas thirrjes me emër të anëtarëve u konstatua se në mbledhje prezentojnë të gjithë anëtarët e zgjedhur gjithsej 31 dhe se mund të vazhdohet me punë.

Pastaj Kryesuesi tha se për këtë mbledhje është paraparë ky:

REND DITE

1. Dhënia e betimit nga anëtarët e Kuvendit të Komunës
2. Dhënia e betimit të Kryetarit të Komunës
3. Zgjedhja e Kryesuesit të Kuvendit të Komunës
4. Fjala përshëndetëse e Kryetarit të Komunës

Pastaj u kalua në punë sipas pikës së parë.

I

Dhënia e betimit nga anëtarët e Kuvendit të Komunës

Lidhur me këtë pikë, Kryesuesi i mbledhjes Nazmi Krasniqi, ftoi anëtarët e zgjedhur të Kuvendit që të ngritën në këmbë dhe të bëjnë betimin duke lexuar deklaratën solemne.
Pastaj anëtarët e Kuvendit duke lexuar deklaratën solemne dhan betimin.

Shtesë: Deklaratat solemne.

II

Dhënja e betimit të Kryetarit të Komunës

Lidhur me këtë pikë, Kryesuesi i mbledhjes Nazmi Krasniqi, ftoi Kryetarin e Komunës z. Imri Ahmetin për dhënien e betimit i cili në vazhdim duke lexuar deklaratën dha betimin para anëtarëve të Kuvendit duke lexuar deklaratën.

Shtesë: Deklarata solemne.

III

Zgjedhja e Kryesuesit të Kuvendit të Komunës

Lidhur me këtë pikë Kryesuesi i mbledhjes Nazmi Krasniqi, njoftoi Kuvendin se për zgjedhjen e Kryesuesit janë të paraparë disa procedura dhe atë:

1. Formimi komisionit zgjedhor dhe
2. Formimi i komisionit verifikues.

Pastaj Kryesuesi i mbledhjes pyeti anëtarët se a ka propozime për anëtarë të komisionit zgjedhor.

Vlora Limani –Hajnuni e propozoi Nehat Tërpezen.
Lulzim Rustemi e propozoi Lumturie Hasanin,
Selatin Retkoceri e propozoi Shkelzen Bislamin,
Ukë Kryeziu e propozoi Ganimete Qeriqin,
Afrim Miftari e propozoi Hajdin Bytyqin,

Për komisionin verifikues u propozuan si vijon:

Vlora Limani propozoi Linda Shahinin,
Lulzim Rustemi propozoi Argjend Tashollin,
Selatin Retkoceri propozoi Albulena Kelmendin,
Ukë Kryeziu propozoi Ukë Kryeziun,
Afrim Miftari propozoi Safete Amërlahun

Pastaj Kryesuesi i mbledhjes Nazmi Krasniqi vuri në votim propozimet për anëtarët e komisioneve dhe pas votimit konstatoi se Kuvendi me 30 vota për aprovoi propozimet për anëtarët e komisionit zgjedhor dhe verifikues.

Në vazhdim Kryesuesi pyeti se a ka dikush propozim për Kryesues të Kuvendit ?

Para se të kalohet për propozim për Kryesues të Kuvendit, fjalën e kërkoi Vlora Limani-Hajnuni e cila në vazhdim tha se së pari Komisioni Verifikues duhet të bëjë verifikimin e mandatit të anëtarëve të Kuvendit pastaj të bëhen propozimet për Kryesues.

Pastaj Kryesuesi i mbledhjes ftoi Kryetarin e Komisionit Verifikues, Linda Shahini e cila pastaj bëri thirrjen me emër të anëtarëve të Kuvendit duke konstatuar se prezent janë 29 anëtarë, dy mungojnë dhe në këtë mënyrë bëri verifikimin e anëtarëve të Kuvendit.

Në vazhdim Kryesuesi pyeti anëtarët se kush ka propozime për Kryesues të Kuvendit.

Vlora Limani-Hajnuni në emër të GP të LDK-së dhe koalicionit AKR,PD,PAI propozoi Daut Azemin.

Lumturie Bytyqi-Hasani në emër të GP të PDK-së e propozoi Nazmi Krasniqin.

Pas këtij propozimi reagoi Nazmi Krasniqi i cili nuk e pranoi propozimin duke e arsyetuar se për shkaqe personale dhe moshës nuk mund ta pranoi këtë detyrë.

Meqë propozime tjera nuk pati për Kryesues të Kuvendit, Kryesuesi i mbledhjes Nazmi Krasniqi ftoi Kryetarin e Komisionit Zgjedhor që të përgatitin listën për votim për Kryesues të Kuvendit.

Pas hartimit të listës nga Komisioni, Nehat Tërpeza ftoi me emër anëtarët e Kuvendit për votim.

Gjatë votimit reagoi anëtarja e Komisionit Zgjedhor Lumturie Bytyqi-Hasani për shkak se një anëtar i Kuvendit votoi haptas.

Pas përfundimit të votimit Kryetari i komisionit Nehat Tërpeza konstatoi se kanë votuar 29 anëtarë, dy kanë munguar dhe prej tyre me 21 vota për, 8 vota kundër Kuvendi zgjedhi Daut Azemin Kryesues të Kuvendit.

Pastaj Kryesuesi i mbledhjes Nazmi Krasniqi ftoi kryesuesin e posa zgjedhur të Kuvendit Daut Azemi për ta udhëhequr mbledhjen të cilit në vazhdim i uroi shëndet dhe punë të mbarë.

Daut Azemi, Kryesuesi i Kuvendit fillimisht i përshëndeti të gjithë të pranishmit në sallë dhe falemndëroi Kryetarin Imri Ahmeti dhe të gjitha strukturat LDK-së dhe koalicionin të cilët e kanë propozuar për Kryesues të Kuvendit. Në vazhdim falemnderoi të gjithë ata që e votuan dhe që smë votuan duke thënë se ky është proces demokratik. Pastaj tha se zgjedhja në këtë post për mua është privilegj, por edhe përgjegjësi dhe besoj se bashkarisht do të ia dalim të kemi një Kuvend të mirë dhe do të punojmë së bashku për interesat e qytetarëve. Në fund falemnderoi edhe Kryesuesin i cili e udhëheqi këtë seancë dhe i uroi shëndet dhe punë të mbarë.

IV

Fjala përshëndetëse e Kryetarit

Lidhur me këtë pikë Kryesuesi i Kuvendit Daut Azemi ftoi Kryetarin e Komunës Imri Ahmeti që të marr fjalën.

Imri Ahmeti, Kryetar i Komunës fillimisht i përshëndeti të gjithë të pranishmit në sallë e pastaj e përshëndeti Kryesuesin e posa zgjedhur e i uroi punë të mbarë pastaj e falemnderoi ekzekutivin e deritanishëm për punën që kanë bërë.

Në vazhdim tha se sot është një ditë e veçant dhe më takon të ju jem falemnderues qytetarëve të Lipjanit sepse sot po rinisim dhe po rimarrim përsëri një detyrë të re dhe përgjegjësi që është sfidë e jashtëzakonshme. Në këtë rast më lejoni të falemnderoi ekzekutivin, asambleistët e deritanishëm, strukturat e partive politike pa dallim, dhe qytetarët e Lipjanit dhe thërras që të angazhohemi të gjithë së bashku për të ndërtuar dhe fuqizuar pushtetin lokal, Unë sot ritheksoj dhe rikonfirmoj se do të jemë i gatshëm të punoj me të gjithë qytetarët e Lipjanit dhe të gjitha strukturat e partive politike pa dallim për të mirën e Komunës së Lipjanit dhe lokaliteteve. Pastaj shprehi falemnderimet për të gjitha gjeneratat brez pas brezi dhe gjeneratën e fundit për kontributin e

dhënë në qështjen e shoqërisë, organizimin të pushtetit tonë,dhe unë edhe sot shprehi falemnderimet e mia të veqanta të gjithë atyre që dhan më të shtrenjten, jetën, e që sakrifikuan për lirinë e sotit.

Unë rikonfirmoj dhe ritheksoi se do të mbetem konsekuent në parimet e mia duke u bazuar në Ligj dhe Zot dhe vetëm me punë mund ta ndryshojmë Lipjanin.

Pasi çështje të tjera nuk pati mbleldhja përfundoi në ora 10,⁴⁵

Ekstraktin e hartoi
Sami Murati

Anëtari më i vjetër e Kuvendit
Nazmi Krasniqi

Kryesuesi i Kuvendit
Daut Azemi